

Dritë

E PERJAVSHME LETRARE ARTISTIKE - ORGAN I LIDHJES SË SHKREMTAREVE DHE ARTISTËVE TË SHQIPERISË

Sa është cilësor «bumi» i romanit?

Një lexues, pasi ka mbaruar romanin «Nata e Ustikës» të shkrimtarit tonë të mirënjoj P. Marko, i drejtosh autorit me një letër të botuar në gazeten «Drita», në kuadrin e rubrikës së hapur prej saj «Libri dhe lexuesi». I entuziazmuar me të drejtë, pasi e përgëzon shkrimtarin, ai shpreh keqardhjen e përzier me habi që një vepër si kjo, duhej shkruar tridhetë vjet më parë. Për hir të një të vërtete, duhet thënë se romanii «Nata e Ustikës», sic dihet nga shumëkush, në mos plot tridhetë vjet, është shkruar së paku rrëth tri dekada më parë. Nga autorit vetë kemi mësuar se shkrimtar dhe botuesi i nderuar D. Siliqi, në atë kohë drejtor i shtëpisë botuese «Naim Frashëri», e kishte me vete një kopje të romanit gjatë një udhëtimi jashtë shtetit, ku ai humbi jetën në një aksident ajror tragjik më korrik të vitit 1963, duke mbetur këshfu një shembull edhe i botuesit të pasionuar. Është i njobur dhe mjaft prekës fakti që kopja në fjalë u gjet gjysmë e djegur midis sendeve që i përkisnin atij... Duke saktësuar këtë të vërtetë qëllimi nuk është të svarojmë diçka që në radhë të parë do t'u interesonte studiuesve ose historianëve të letërsisë e që, gjithë

thsesi, sic do ti kthehem edhe më poshtë këtij fakti, ka rëndësimë e vet. Dua të them se duke ndjekur anketën e «Dritës», nuk u habita aspak që romani «Nata e Ustikës» ishte libri më i lexuar gjatë muajit korrik të këtij viti. Përse?

Kjo është një pyetje që vettetiu të shkon nëpër mend së bashku me vargun e titujve të romanave të botuar gjatë 10-12 muajve të fundit. Të bën përshtypje edhe diçka tjetër nga kjo rubrikë. Një lexues nga një fshat verilindor ankohet dhe shtron pyetjen se kur do ti vijë radha të lexojë romanin «Koncert në fund të dimrit» të Kadaresë, roman që ndërkaj u shpall në Francë nga mjaft revista e gazeta si libri më i mirë i vittit 1989. Edhe këtë nuk dua ta përmend thjesht që, si botues, të informoj me këtë rast lexuesin se botimi i dytë i «Koncertit...», variant i ripunuar dhe i përmirësuar dukshëm nga autori tashmë ndodhet në shtyp e shumë shpejt do të vihet në qarkullim. Dua të kujtoj se nga botimi i parë i «Koncertit...» me një tirazh të madh, s'kanë kaluar as tre vjet dhe ai mbetet një libër mjaft i kërkuar. Përse?

Dy pyetjeve të mësipërme, në mënyrë disi të thjeshtëzuar mund

të përgjigjesh se romanet që përmendëm, në radhë të parë janë libra të lexueshëm në kuptimin më të gjerë të fjalës. Për «Koncertin...», dhe dimensionet e saj si vepër e përmasave të mëdha ka shkruar kritika botërore dhe kritika jonë, e në këto shënimë nuk po ndalem. Për më tepër kur objekt i tyre janë disa nga veprat e vëna në qarkullim nga janari i këtij viti e këtej. Po «Nata e Ustikës»? Lexuesi ndesh aty një temë jo të panojohur, që tanë, drejt fundit të shkullit, mund të tingellojë edhe si e kapercyer në kohë, pra mund të mos ngjallë ndonjë interes. Përkundrazi, romani duket se e ka siguruar lexuesin dhe sukseen masiv. Sepse, së pari, ai është një roman i lexueshëm në të gjitha pikëpamjet.

Për të sqaruar mendimin është e nevojshme ta hedhim vështrimin prapa, ndonëse jo shumë larg. Para pak vjetësh, romancierët tanë, ashtu si gjithë krijuarët, u ballafuan seriozisht me konceptet «mediokër» dhe «mediokritet». Nuk munguan edhe krijuarë që, pa u thelluar e pa i kuptuar kërkosat që shtroheshin, hapën fjalorët dhe të habitur mësuan se termi «mediokër» në shqip përkthehej pak a shumë me fjalën e pafajshme «mesatar». Atëherë, thanë ata, kur s'ke pulën do të hash sorrën, sic thotë proverbi. Kështu dhe në letërsi. Ky është arsyetimi tipik i të gjithë atyre që as përparrë disa vitesh e as sot e kësaj dite nuk arrijnë të

(vijon në f. 2)

Fatos Kongoli

NE KETE NUMER

- | | |
|--|-------|
| . Tre probleme të «Historisë së letërsisë shqipe». | f. 5 |
| . Profile tradite. | f. 6 |
| . Novelë: Gjysma tjetër e detyrës. | f. 8 |
| . Portret: Uilian Folkner. | f. 13 |
| . Një arbëresh i dashuruar me letërsinë shqipe. | f. 16 |

Filma të rinj të Kinostudios

Sic dihet në fillim të këtij viti kinostudioja «Shqipëria e re» prezantoi përparrë publikut kinokomedinë e Bujar Kapexhiut «Edhe kështu, edhe ashtu», që u prit mjaft mirë nga shikuesit. Më pas u shfaqën filmat «Muri i gjallë» me regjisori M. Fejzo, «Njerëz në rrymë» me regjisore Grigor Stavri, Besnik Bisha, «Lumi që nuk shteron» me regjisori Fatmir Koçi e Flamur Koçi. Këto ditë po shfaqet filmi artistik «Djali elastik» i regjisoris Besim Kurti. Gjithashtu u organzuat një gjithë kinematë e vendit aktiviteti «Retrospektivë e filmit shqiptar dhe të huaj». Ky aktivitet organizohet për herë të parë dhe u frenkuentua nga një numër i konsiderueshëm shikuesish. Si rrjedhim, kinematë e realizuan planin 6-mujor në masën 100 përqind.

Me masat e marra është gati për t'u shfaqur filmi artistik «Vitet e pritjes», i realizuar nga Esat Musliu, regjisori, skenaristë Teodor Laço e Esat Musliu. Pëllumb Kalla, operator, Ilia Xhokaxhi, piktori, Limoz Dizdari kompozitor. Në rolet kryesore: Xh. Ferri, M. Ljarja, R. Bulku, R. Ferri etj. Film trajton temën e kurbetit. Gjon Kodri kthehet nga vendi i huaj ku pat shkuar, me iluzionet e një jete më të mirë. Guri rëndon në vend të vet: Kjo ide themelore përshkon dy pjesët e filmit duke nxjerrë në pah me realizëm e dramacitet tragjedinë e kurbetit. Pritet të dalë edhe filmi artistik «Ballada e Kurbinit», i realizuar nga regjisori Kujtim Çashku, skenarist Vath Koreshi, operatorë Spartak Papadimitri i Leonard Qendro, piktori Namik Prizreni, kompozitor Feim Ibrahimini. Në rolet kryesore: R. Arbana, N. Luca, T. Filloko etj.

Filmi «Pas takimit të fundit» është realizuar nga Fehmi Oshafi, regjisori, Bashkim Kozeli - skenarist, Mihal Rama, operator Azzis Karalliu, piktori, Tasim Oshafi, kompozitor. Në rolet kryesore: A. Tartari, F. Sela, V. Muzha etj. Ky film trajton një temë shoqërore që merr shkas nga disa ngjarje të jetës ushta-

(vijon në f. 3)

Autorë te rinj

Një ditë, në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve tek po biscedonim me shkrimtarët Nasi Lera e Zija Çela, njohëm Gjek Marinajn, një djalosh 22-vjeçar nga Bajza e Kastratit të Shkodrës. Patëm rastin të zbulojmë tek ai poetin nga leximi i fletores së tij poetike të cilën mezi ia «xhatavëm» duke thyer «barrierën» e modestisë. «Merre Ndoci, se ty të taken t'ia kthesh kënaqësinë që na dhuroi leximi i poeziave të tij më të mira», - më tha Nasi Lera. Dhe unë po e kryej porosinë pa shtëzim në marrëdhënien me vjetveteren, sepse poezitë e tij më pëlgjen dhe pashë tek ai filletarin e jorëndomtë. Nuk po flas përvlerat e poeziave të Gjekës. Jam i bindur se nuk po tregohem një ndërmjetës i keq apo sentimental në mes poetit të ri dhe gazetës «Drita» e lexuesve.

Ndoc Gjetja

Gjekë Marinaj

Mos më ik larg, poezi

Krejt i vogël më ngjan vjetja, sa çap në rrugën tende diku, duke provuar djegien e lehtë të një hithëre diku, duke ndjerë dhëmbjen e shpimit të një gjëmbi diku, duke lundruar mbi ca fletë të quditshme drite. Herë eci ngarkuar hundebuzë me një melankoli të tèrbuar Si luan kështu me mua, poezia ime, tempulli im?! Ti e di se gjithmonë jam magjepsur pas çudirave të poetëve, Ka kohë, pa vënë re, për tek ti imitoj rrrokullisjet e orteqeve, Se dua të rritem, të rritem patjetër. Nisem nga cepi i mëngjesit për te mbrëmja e rrëzimit të ditës dhe èmbëlsi e syve të vajzës që dua rëndon mbi mua dhe lodhem duke ndjekur me njerëzit gjurmët e zhdukshme të diellit dhe prapë rrrokullisjen mbushëse drejt teje ma udhëshpejton dëshira për të të përqafuar... kujdes, mos më lëndo shumë duke më ikur larg, poezia ime - tempulli im!

Vonesa e motrës

Kam një lëndinë diku brenda meje Që malli për ty motër, karthëve Ua dogji gjethet...

Barin dhe lulet i qëmendi heshtja Dhe rëndën pas teje.

Livadhet mbetën ftyrë rrreshkura,

Si gra vejusha - pa tualet.

U vonove shumë kësaj here.

Pemët i lëshuan nëpër tokë fletët... E zogjtë vrapijnë pas tyre të të gjejnë

Me mendimin se janë gjurmët e tua..

Ata ecin e lëndinën e mundon

Një pritje e gjatë.

Oh, sa mirë që s'ma sheh lëndinën e shpirtit Të vjeshtëruar kështu!

Eja pranveromë, motër e dashur!

Po të pres!

Te paktën në èndërr...

Përkundem në èndërr në mijëra djepe dëshirash.

Fluturoj mbi fusha, male, planete..

Duke të kërkuar ty e dashur - vajzë e qillit.

Të gjej në sfondin më të vëtmuar të botës.

Hap krahët të të përqafoj...

Në çast èndrra më bëhet e pabesueshme.

Largojet prej meje e trembur, si një harabel,

unë zgjohem më i zemëruar se Akili.

Me c'plumb të vras trishtimin, e dashur!?

Të paktën në èndërr të thyente qafën mungesa jote!!

Kua jt

Tërë jetën duke vrapiuar rrjmë

Shohim veç përparrë

C'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.

Ne nuk kemi emër

të gjithëve kuaj na thonë,

Nuk qajmë,

Nuk qeshim.

Heshtim.

Dëgjojmë.

Hamë atë q'na jepin,

Ecim nga na thonë,

Asnjë nga ne s'është mendje hollë

Kush qe kalë mbreti,

Posti qe i lari.

Kush qe kalë princeshe

I bënë shalë të artë

Kush qe kalë fshatari

Pat samarë me kashtë

Kush qe kalë i egër

Tërë jetën fjeti jashtë.

Por gemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!

(vijon nga f. 9)

u pëlqen ushqimi a, gatimi, a, vendi, a...

- Jo, jo. Çdo gjë ishte e mrekullueshme, - tha djali me një gesëndi fare të lehtë në zë, - Ju siguroj se deri këtu u kënaqëm. Por një punë e papritur...

Drejtori u dorëzua, zgjati kokën në derë dëhe i thirri Sherafit. I ndjeva hapat e tij të ngadalshëm. Lakuriq si gjithmonë nga mesi e lart, ai doli një hap para çiftit dhe i shkeli syrin drejtorit. Ata shkëmbjen në të dhjetën e sekondës një mori sinjalesh të tjera që vetëm një djall mund t'ua merte vesh kuptimin. Fytyra e Sherafit në ato çaste më shëmbellë me fushën e sahatit ku pluskon e lëviz diçka, pavarësisht se akrepat duken si të gozhduar në vend.

- Eh, mirë shkoni, - tha drejtori tashmë kryelartë dëhe i gjallëruar plotësisht. - Ky shoku do t'u marrë në dorëzim dhomën.

Shtëpia e pushimit nuk i kishte asnjë borxh atij çifti të mërzitur.

Ndërsa po dilte me nxitim, duke futur këmishën në pantallona, drejtori ktheu kokën dëhe shtoi me rreptësi pa ia shqitur sytë djalit:

- Shpresoj se nuk do të na kujtoni për të keq!

Djalit i lëvizti një nerv në ballë, i futi krahun vajzës dëhe e tèrroqi pa pikë delikatese. Vajza shtrëngoi nosullat dëhe e ndoqi të shoqin pa folur. Më erdhë për të klithur. Një yll i brishtë bukurie kishte rënë në duart e një hajvani. Shumë shpejt ka për t'u fishkur përfare, mendova, dëhe vetëm ndërimi i lartë, adhurimi qilleror mund ta ripërtërijnë e fisnikërojnë rishtas. Por bashkëshortit të saj dukej se i mjaftonte përdorimi i gjërave përfi t'i nënveftësuar.

Ajo po ikte dëhe kampi m'u duk i vëtmuar, vjeshtor, bosh, a thua se prania e asaj gruaje të re ia kishte dhuruar shkëltqimin dëhe finesën dëhe tanë që po ikte po i merrte me vete, duke i tèrhequr përmes xhamave të mëdhenj të bilardos ku isha ngujuar si në pritë, i pafuqishëm për të kthyer mbrapsht atë largim të dhimbshëm pigmentesh, farfurish dëhe reflekshesh. Dhe m'u bë se zogu prijës i vjshtës klithi diku midis fushave dëhe shpirti im rrahu 'N'atrat në xhamë: Ikim! Ikim!

- E di ti pse na la shëndetin ai çifti?

U rrotullova me gjithë stol, u ngrita në këmbë dëhe ngritis supet. Sherafi e shpërfilli me një prepotencë të hapur mosdashjen time përtë mësuar pse kishte ikur ai çifti. Fytyrëcelur, duke lëshuar si gjyrky frymën që kundërmonte erë supë, hodhi tre hapa përpara, ngriti në lartësinë e veshëve qishtat tregues të duarve slkur më thoshtë: shiko këtu, vetëm këtu!

- Oj, po pse ke frikë? - pyeti me dhëmbëshuri e qortim dëhe, pasi u sigurua se vala e hutimit të parë më kaloi, rrëmbeu stekën dëhe i ra me të cokut. Bilat e mbledhura ala spartancë në qendër të tryezës u shpërndanë me kërcitje e tollovi andej këndeji. Sherafi gjëzoi si fëmijë dëhe teksha lozta me bilat zuri të më shpjetgonte se shtëpia e pushimit nuk ishte han ku njeriu mund të bëjë çfarë t'i tekët. Kam një paragjikim sikur shumë rregulla që disiplinojnë jetën nuk gjunjë zbatim këtu buzë detit. Dhe ai që injorohet i pari është pikërisht rregulli i vigjilencës. O burra, pushim, det, rërë, trupa të zhveshur topa me ngjyra, aheng, shëtitje deri vonë, zgjimi pa orar, pa brigadier, përgjegjës e shef mbi krye. Askush nuk don të dijë çfarë bëri tjetri, askush nuk rezervohet nga prania e tjetrit, plazh hesapi, me pak fjalë, qejf deri në kufë të gjurit. Kështu e gjykjnë punën disa dëhe ja ku zgjohen në ndërgjegjen e tyre ca dëshira të fjetura që deri dje i kanë mbajtur fre për shkak të kodeve moralë. Eh, këtu qenka plazh, pallë, kodi moral pushuaka së ekzistuar dëhe fap kuzhineri fut rriskën e gjalpit në cantë, farë burri i botës puthet me femrën në sy të botës. Tjetri var radion në qafë dëhe me demek na shëtit nëpër botë, tjetri bëhet xurxull në klub dëhe vend që të zbrësë nga shkallët i bie shkurt dëhe hidhet nga taraca, tjetri del nga hoteli si kokrra e mollës dëhe na i grimshet doktorit përsë nuk jepen barna për t'i evituar mbetjen me barri të grave... Me pak fjalë tipa të tillë kujtojnë, sikur shtëpia e pushimit s'ka as sy, as veshë. Por, jo, jo, jo...

- Eja me mua! - urdhëroi duke lëshuar stekën e bilardos dëhe, krejt i murrëtyer në ftyrë, më hoqi udhën drejt një zyre ngjitur me drejtorinë. Gishtërinjtë i dridheshin si në ethe, mezi e futi celësin në bravë, qivitë kuisën dëhe ndryshku i tyre sikur më lëndoi koe ka' dëhe pata ndjesinë sikur po hyja në një sarkofag.

Brenda ishte errësirë Dritaria që shihte nga veriu ishte zënë me perde. Sherafi ndezi një ambazhur të vogël dëhe sytë e mi brodhën përmbi inventarin e varfér të asaj zyre; një tryezë e gërvishtrur me ca fletore përsipër, një kanë dhë një govatë, një arkë me shishe birre të zbrazura, një qadër plazhi e dalë boje, katër-pesë pjata me mbeturina gjelle hedhur në një skaj - pastaj u ndalën mbi gishtërinjtë e Sherafit gishtërinj të trashë, me xhuska qimesh me kyce që bënin fash fash teksha shfletetonin një fletore.

- Ja dëhe historia e atij çiftit, - tha i gjallëruar dëhe më la në dorë fletoren e hapur diku nga fundi Filloj të vinte rrotull pa m'i ndarë sytë. Ata sy që jashtë dukeshin si të fjetur, tanë ishin energjikë plot zjarr dëhe forcë, mjekra e tij e ngritur paksa lart më përfytyronte gadishullin e Karaburunit në hartë. Kisha përshtypjen se vështrimi i tij më lidhej trupit si litar dëhe më shtrëngonte gjithnjë e më fort. Hë luaj tanë ti që s'ke dashur të mësosh asgjë nga hynerat e mia.

Fillova të lexoj.

Data tre

Një çift nga Shkodra e pashë duke u shpërlarë në dush. Talleshin apo s'talleshin me ujin dëhe shoshat e dusheve. Më thotë mendja se ai djali tallet edhe me ato pak alga në ujin e detit me qadrën, kovën dëhe legenin që kanë tèrhequr nga magazina. Zotëria e tij. Në mbrëmje kaluan nga pishat e kampit. Djalit nuk i rrinë duart rehat. E